



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government*

Për:	Bekim Jashari, Kryetar i Komunës së Skenderajt Fatbardha Haliti, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	<i>P</i> Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL <i>B</i>
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Datë: 04.02.2021 Nr.020-886/16
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave <i>M</i>
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave <i>A</i>
Lënda:	Shkresë shpjeguese e aktit të Komunës së Skenderajt
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 01-463/01-0003271/21 për plotësimin e Vendimit Nr. 01-463/02-0049243/19 të datës 06.08.2019 për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë kompanisë rajonale të Ujësjetës "Mitrovica" njësia në Skenderaj dhe kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI"
I miratuar më datë: 19.01.2021
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 21.01.2021

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se Vendimi Nr. 01-463/02-0049243/19 të datës 06.08.2019 për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë kompanisë rajonale të Ujësjetës "Mitrovica" njësia në Skenderaj dhe kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI" nuk është plotësuar sipas kërkesës së MPL-së Nr. 020-886/6 të datës 22.08.2019.

Sipas asaj që është cekur me lartë bazuar edhe në legjislacionin në fuqi, MPL qëndron prapa kërkesës së datës 22.08.2019.

Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government

Za:	Bekim Jashari, gradonačelnik opštine Srbica Fatbardha Haliti, predsedavajuća Skupštine opštine Srbica	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-sa Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara MLS-a.	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja monitorisanje opština, MLS	Dana, 04.02.2021.
Službenik-ca za kontrolu:	Xhevat Tafa, rukovodilac Ouseka za monitorisanje opština	Br.020-886/16
Službenik-ca za izradu:	Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Pismo objašnjenja akta Skupštine opštine Srbica	
Vrsta akta:	Odluka skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,  
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka skupštine opštine br. 01-463/01-0003271/21 o dopuni izmeni Odluke br. 01-463/02-0049243/19 od dana, 6.08.2019. godine, za davanje na dugoročno korišćenje imovine Regionalnoj kompaniji vodovoda "Mitrovica" jedinica u Srbici i kompaniji za prikupljanje smeća "UNITETI"

Usvojena dana, 19.01.2021.

Predložena na razmatranje u MLS-u, dana, 21.01.2021.

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da Odluka br. 01-463/02-0049243/19 od dana, 6.08.2019. godine, za davanje na dugoročno korišćenje imovine Regionalnoj kompaniji vodovoda "Mitrovica" jedinica u Srbici i kompaniji za prikupljanje smeća "UNITETI" nije dopunjena prema zahtevu MLS-a br. 020-886/6 od dana, 22.08.2019.

Prema gore navedenoj, na osnovu zakonodavstva na snazi, MLS ostaje pri zahtevu od dana, 22.08.2019. Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

09-463/01-0002363/210  
29.09.2021

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministry of Local Government Administration			
Date: 29.09.2021			
Date:			
Date:			
Numri i Organizimit	Kr.	Lokali	Shtetja
-U-	02	Skenderaj	028/16

Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/ Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, 12 par. 1, 2 shkronja d), neni 14, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, qershor 2008, neni 50 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshëm të Komunës, Rregullores (QRK) nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 6 par. 1 nen par. 1.2, neni 11 par 1 nen par 1.1 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, dhe u bazuar ne Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025, si dhe Hartën Zonale të Komunës së Skenderaj, dhe neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 19.01.2021 miratoi këtë:

### **V E N D I M**

(Për Plotësimin e Vendimit Nr.01-463/02-0049243/19 të datës 06.08.2019 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë kompanisë rajonale të Ujësllësit "Mitrovica" njësia në Skenderaj dhe kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI")

#### **Neni 1**

Miratohet propozimi-vendimi me nr.02-463/01-0002363/210, të dt.15.01.2021, Për plotësimin e Vendimit Nr.01-463/02-0049243/19 të datës 06.08.2019 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë kompanisë rajonale të Ujësllësit "Mitrovica" njësia në Skenderaj dhe kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI", me arsyetimin lidhur me kërkesën e Institucioneve Qendrore të Republikës së Kosovës për dhënien e pronës në shfrytëzim

#### **Neni 2**

Këtij vendimi i bashkëngjitet:

Vendimi i Kuvendit Nr.01-463/02-0049243/19 i datës 06.08.2019.

#### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit.

#### **Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 15 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb-faqen e komunës.

### **ARSYETIM**

Kuvendi Komunal në Skenderaj me datë 31.07.2019 ka marrë vendim Nr.01-463/02-0049243/19 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë kompanisë

rajonale të Ujësjetlësit "Mitrovica" njësia në Skenderaj dhe kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI", të cilin vendim me datë 22.08.2019 e ka dërguar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

MAPL brenda afatit kohor ka kthyer përgjigje për ligjshmërinë e aktit me arsyetimin se nuk ekziston një kërkesë e adresuar nga Institucionet Qendrore të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar në nenin 21 të Ligjit 06/L-092.

Vlen të theksohet se prona që i është dhënë në shfrytëzim kompanisë së Ujësjetlësit ka qenë projekt i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik e cila e ka financuar në formë donacioni ngritjen e objekteve për Kompaninë e ujësjetlësit KRUM "Mitrovica", njësia në Skenderaj, që do të thotë se ky projekt i shërben dhe i përgjigjet vetë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

KRUM, njësia Skenderaj ka qenë e vendosur përkohësisht në objekt në pronësi të komunës, ku titullar i ngastrës është komuna jonë, pas kësaj me një vendim numër 01/Nr. 463-66 i datës 05/08/2011 është vendosur në një objekt tjetër gjithashtu në pronësi të komunës së Skenderajt, vendim ky i anuluar me vendim të Kuvendit Komunal në seancë të rregullt mbajtur me datë 31/07/2019 për të cilin ka ardhur nga MAPL ligjshmëria pozitive, kurse komuna jonë në bazë të Planit Rregullativ Urban, në përputhje me PZHK-në, e ka të përcaktuar lokacionin për ngritje të objektit të KRUM "Mitrovica", objekt ky i cili tashmë është në ndërtim e sipër në Zonën Kadastrale Llaushë ngastra numër P-72015041 - 01402-0.

Pra me vendimin në fjalë Komuna ka zhvendosur KRUM "Mitrovica" njësinë në Skenderaj, nga një pronë komonale që është shfrytëzuar me vite të tëra në një pronë tjetër pas kërkesave të shumta që kanë ualë nga ky institucion me pajtueshmërinë e bordit menaxhues të Kompanisë Rajonale.

Ndërtimi i objektit në këtë hapësirë publike Komunale është bërë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (Tani Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit) e cila ka planifikuar buxhet, ka zhvilluar procedurat e prokurimit, ka lidhur kontratë me kompaninë fituese të tenderit, dhe e ka mbikëqyrur realizimin e këtij projekti.

**Vendimi i Dërgohet :**

- 1x1 Arkivit;
- 1x1 Zyrës së Kryetarit;
- 1x1 DGJKP-së;
- 1x1 DUMA-së;
- 1x1 MPL-së;
- 1x1 Dosjes.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

01-463/01-002363/21  
15.01.2021



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Prodecdnika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58.shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 50 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, Kuvendit të Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë \_\_\_\_\_ 2021, Kryetari i Komunës i:

**PROPOZON**

- I. Plotësimin e Vendimit Nr.01-463/02-0049243/19 të datës 06.08.2019 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI" dhe kompanisë rajonale të Ujësjiellit "Mitrovica" njësia në Skenderaj, me arsyetimin lidhur me kërkesën e Institucioneve Qendrore të Republikës së Kosovës për dhënien e pronës në shfrytëzim.
- II. Ky propozim Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

**ARSYETIM**

Kuvendi Komunal në Skenderaj me datë 31.07.2019 ka marrë vendim Nr.01-463/02-0049243/19 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI" dhe kompanisë rajonale të Ujësjiellit "Mitrovica" njësia në Skenderaj, të cilin vendim me datë 22.08.2019 e ka dërguar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

MAPL brenda afatit kohor ka kthyer përgjigje për ligjshmërinë e aktit me arsyetimin se nuk ekziston një kërkesë e adresuar nga Institucionet Qendrore të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar në nenin 21 të Ligjit 06/L-092.

Vlen të theksohet se prona që është dhënë në shfrytëzim kompanisë për ndërtimin e objektit për grumbullimin e mbeturinave ka qenë projekt i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik e cila e ka financuar në formë donacioni ngritjen e objekteve për Kompaninë e ujësjiellit KRUM "Mitrovica", njësia në Skenderaj, që do të thotë se ky projekt i shërben dhe i përgjigjet vetë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

KRUM, njësia Skenderaj dhe "KRM Uniteti" njësia Skenderaj, kanë qenë të vendosura përkohësisht në objekt në pronësi të komunës, ku titullar i ngastrës është komuna jonë, pas kësaj më një vendim numër 01/Nr. 463-66 i datës 05/08/

2011 janë vendosur në një objekt tjetër gjithashtu në pronësi të komunës së Skenderajt, vendim ky i anuluar me vendim të Kuvendit Komunal në seancë të rregullt mbajtur me datë 31/07/2019 për të cilin ka ardhur nga MAPL ligjshmëria pozitive, kurse komuna jonë në bazë të Planit Rregullativ Urban, në përputhje me PZHK-në, e ka të përcaktuar lokacionin për ngritje të objektit të KRUM "Mitrovica" dhe "Uniteti", njësitë në Skenderaj, objekt i cili tashmë është ndërtuar në Zonën Kadastrale Llaushë ngastra numër P-72015041 - 01402-0.

Pra me vendimin në fjalë Komuna ka zhvendosur KRUM "Mitrovica" dhe "KRM "Uniteti", njësitë në Skenderaj, nga një pronë komunale që janë shfrytëzuar me vite të tëra në një pronë tjetër pas kërkesave të shumta që kanë dalë nga këto institucione me pajtueshmërinë e bordeve menaxhuese të të dy Kompanive Rajonale.

Ndërtimi i objektit në këtë hapësirë publike Komunale është bërë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (Tani Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit) e cila ka planifikuar buxhet, ka zhvilluar procedurat e prokurimit, ka lidhur kontratë me kompaninë fituese të tenderit, dhe e ka mbikëqyrur realizimin e këtij projekti.

Bashkangjitur këtij propozimi: Vendimi Nr.01-463/02-0049243/19 i datës 06.08.2019.

Iu dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së



Kryetari i Komunës

Bokim Jashari



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO  
MUNICIPALITY OF SKENDERAJ



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

01-463/01-0043806/19  
06.09.2019

### Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Pas shqyrtimit të propozim-vendimit nr.05-463/01-0043806/19, të dt.15.07.2019, në bazë të dispozitave të nenit 12 par 1,2 shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, qershor 2008, neni 6 par.1, nen par 1.2, neni 14 par. 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, neni 6 par. 1 nen, par.1.2 . nen, par. 1.2.1 dhe 1.2.2, neni 11 par. 1 nen, par 1.1 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor , neni 14 par. 1,2 shkronja d, të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 31.07.2019 miratoi këtë:

### V E N D I M

#### **PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME NË SHFRYËTZIM AFATËGJATË KOMPANISË PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE “UNITETI” DHE KOMPANISË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT “MITROVICA” NJËSIA NË SKENDERAJ**

- I. Miratohet propozim-vendimit nr.05-463/01-0043806/19, të dt.15.07.2019, për dhënie e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë kompanisë për grumbullimin e mbeturinave “UNITETI” dhe kompanisë rajonale të ujësjellësit “Mitrovica” njësia në Skenderaj.
- II. Ngastra e dhënë në shfrytëzim gjendet në parcelën kadastrale nr.1402-0 ZK Skenderaj me sipërfaqe të përgjithshme 6744 m<sup>2</sup>.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të cekur në pikën II të këtij vendimi është për nevojat e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica” njësia në Skenderaj dhe Kompanisë për grumbullimin e Mbeturinave “Uniteti” në Skenderaj.
- IV. Afati kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale të përkrahur në pikën II të këtij vendimi është afatgjate prej 20(njëzetë) viteve, kjo pronë jepet në shfrytëzim pa kompensim.

- V. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen të Ambientit me shkresën nr.06-350/02-0042868/19 të dt.11.07.2019, jep sqarim Urbanistik, sipas dokumenteve të planifikimit të Komunës së Skenderajt siç janë PZHK-së dhe PRRU-së kjo pronë i takon zonës ku parashihet të ketë ndërtime me densitet të ulët, ky sqarim lëshohet me qëllim të informimit rreth destinimit të pronës.
- VI. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen e Komunës.

**Vendimi i Dërgohet :**

1. Arkivit
2. MAPL-së
3. Zyrës së Kryetarit
4. DGJKP-së
5. Dosjes







Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Bekim Jashari, Kryetar i Komunës së Skenderajt Fatbardha Haliti, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Data: 14/08/2019 Nr.020-886
Zyrtari kontrollues:	Jeton Qela, U.D. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
Zyrtari hartues:	Driton Xhafa, Zyrtarë për Monitorim të Komunave
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,  
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr.01-463/02-0047243/19 për dhënie e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI" dhe kompanisë rajonale të ujësjellësit "Mitrovica" njësia Skenderaj

I miratuar më datë: 31/07/2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07/08/2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim Nr.01-463/02-0047243/19 për dhëniën e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI" dhe kompanisë rajonale të ujësjellësit "Mitrovica" njësia Skenderaj	Vendim Nr.01-463/02-0047243/19 për dhëniën e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI" dhe kompanisë rajonale të ujësjellësit "Mitrovica" njësia Skenderaj, është në kundërshtim me, nenin 21, të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhëniën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili trajton procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta.  Arsyeja është se nuk ekziston një kërkesë e adresuar nga Institucionet Qendrore të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar me Ligjin e lartcekur.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

## Vjosa Ahmetaj

---

**From:** Vjosa Ahmetaj  
**Sent:** 04 February 2021 14:51  
**To:** Fatbardha Haliti  
**Cc:** Xhevat Tafa; Muje Selmani  
**Subject:** Njoftim....

E nderuar,

Ju njoftoj se do të vonohet vlerësimi i ligjshmërisë së akteve të miratuara në Kuvendin e Komunës së Skenderajt në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 19.01.2021, andaj ju lutem të mos publikohen aktet deri sa të pranoni vlerësimin e ligjshmërisë,

Ju falënderojmë për mirëkuptim dhe bashkëpunim!..

Me respekt,  
Vjosa Ahmetaj